

**UDHËZIM**  
**Nr. 280, datë 17.5.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2365, DATË 26.11.2008, “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 277, DATË 18.6.1997, ‘PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT’”, I NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar, dhe pikën 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit’”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, paragrafi i tretë, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Për rivlerësim shqyrtohet dokumentacioni mjekësor i rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit”.

2. Në pikën 2/2 togfjalëshi “për tu pajisur me epikrizën”, zëvendësohet me “për të përgatitur dokumentacionin mjekësor të rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit”.

3. Pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“10/1. Dokumentacioni për ndjekjen e arsimit të mesëm të lartë merret nëpërmjet ndërveprimit mes Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Albana Koçiu**